

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Konsumi dhe e drejta e konsumatorit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti II, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+0
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	Salla S4
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Ass.Dr. Artor Nuhiu
Detajet kontaktuese:	artor.nuhiu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p><i>Globalizimi, revolucioni në teknologjinë e Informacionit dhe komunikimit, dhe industrializimi i shpejtë kanë sjellë ndryshime të mëdha në nevojat tona, perceptimet, modelet e sjelljes, qëndrimin ndaj të drejtave, përgjegjësi dhe shqetësimeve tona si konsumatorë. Në vendet në zhvillim, këto çështje janë bërë më problematike dhe kanë bërë të nevojshme edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Ligjet për mbrojtjen e konsumatorit përpunohen të mbrojnë konsumatorët duke ndaluar praktikën e biznesit që janë të padrejta ose mashtruese konsumatorët. Kjo lëndë trajton një përmbledhje të koncepteve themelore mbi konsumimin dhe mbrojtjen e konsumatorit, teorive dhe praktikave të ndryshme të mbrojtjes së konsumatorit në disa vende të botës dhe Evropës Perëndimore, shqyrtimin e kornizës ligjore në lidhje me trajtimin e dëmeve të shkaktuara ndaj konsumatorëve dhe ekonomisë nga bizneset e papërgjegjshme.</i></p>
Qëllimet e lëndës:	<p><i>Qëllimi i kësaj lëndë është t'u ofrojë studentëve një kuptim të parimeve dhe koncepteve që rregullojnë fushën dhe politikën e mbrojtjes së konsumatorit, dhe t'u mundësojë studentëve të studiojnë kornizën rregullative institucionale të mbrojtjes së konsumatorit dhe marrjen gjithnjë në rritje të masave për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë dhe vendet e BE-së. Në aspektin praktik, lënda synon të rrisë ndërgjegjësimin e studentëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e konsumatorëve dhe të jenë të vetëdijshëm për mjetet në dispozicion për t'i zbatuar ato të drejta. Në përfundim të ciklit të ligjëratave nga kjo lëndë, studentët do të arrijnë t'i kuptojnë më mirë teorinë dhe argumentet rreth konsumit dhe shoqërisë konsumatore</i></p>

	<i>dhe të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato në shembuj specifikë. Gjithashtu, studentët do të motivohen të mësojnë më shumë se si konsumi dhe praktikat e konsumatorit formësojnë shoqërinë tonë dhe ndikojnë në jetët tona.</i>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p><i>Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Kuptojnë dhe trajtojnë problemet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga diapozitat ligjore në fuqi që mbulojnë fushën e mbrojtjes së konsumatorëve;</i> • <i>Studiojnë rritjen dhe origjinën e lëvizjes së konsumatorëve në nivel global;</i> • <i>Njohin të drejtat e disponueshme për konsumatorët në bazë të ligjit për mbrojtjen e konsumatorit dhe ligjeve të tjera të lidhura;</i> • <i>T'u nxitet interesimi të mësojnë më shumë rreth traditës, realizimit dhe respektimit të të drejtave të konsumatorit;</i> • <i>Të jenë të aftë për vlerësim objektiv të sjelljes së prodhuesëve dhe tregtarëve në raport me konsumatorin.</i>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	15	30
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	4	16
Përgaditja përfundimtare për provim	6	2	12
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	5	2	10
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			100 orë

Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Mësimi do të organizohet nëpërmjet ligjeratave (hyrëse), nëpërmjet debateve dhe bisedave interaktive, të komentimit të literaturës në grupe. Gjatë ligjerimit do të shfrytëzohen mjete bashkëkohore teknike për</i>
-------------------------------------	--

	<i>demonstrim, studentëve çdo ligjerat do t'i dorëzohet edhe me shkrim në fillim të orës së mësimi. Mundësisht dhe varësisht nga mundësit teknike dhe organizative do të organizohet edhe puna praktike nëpër institucionet gjegjëse të Kosovës, në ministri dhe inspektoriate.</i>
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë: 30% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 5% Vijimi i rregullt: 5% Provimi fina: 30% Total 100%</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>Ligjërata të autorizuara, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2023.</i> <i>Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit i Kosovës.</i> <i>Programi për mbrojtjen e konsumatorit – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.</i>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> <i>James Devenney, Mel Kenny – European Consumer Protection: Theory and Practice, Cambridge University Press, 2012.</i> <i>Stephen Weatherill – EU consumer law and policy- Edward Elgar (Elgar European law), 2005.</i> <i>Susanne Borch, Dennis Campbell – International Consumer Protection, Volume 2, Springer Netherlands, 1995.</i> <i>Jane K. Winn – Consumer Protection in the Age of the 'Information Economy', Markets and the Law, Ashgate Pub Co, 2006.</i>
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Ligjërata hyrëse- prezantimi i syllabusit të lëndës
Java e dytë:	Kuptimi i përgjithshëm mbi konsumin dhe konsumatorin
Java e tretë:	Përmbajtja e punës së organizatave të konsumatorëve; Lëvizja e konsumatorëve – Konsumerizmi
Java e katërt:	Organizimi i konsumatorëve në botë dhe institucionalizimi i problemit të konsumatorëve; Organizimi i konsumatorëve në shtetet e Evropës Perëndimore (Francë dhe Gjermani)
Java e pestë:	Organizimi i konsumatorëve në shtetet e Evropës Perëndimore (Angli, Suedi, Zvicër dhe Belgjikë)
Java e gjashtë:	Bashkëpunimi ndërkombëtar i organizatave për mbrojtjen e konsumatorëve
Java e shtatë:	Teoria e sovranitetit të konsumatorit
Java e tetë:	Kollofiumi i parë
Java e nëntë:	Kualiteti si instrument i mbrojtjes së konsumatorëve
Java e dhjetë:	Propaganda ekonomike dhe kërkesat e konsumatorëve
Java e njëmbëdhjetë:	Standardizimi si mënyrë e mbrojtjes së kualitetit të produkteve që

	janë në interes për konsumatorin
Java e dymbëdhjetë:	Roli i inspektionit dhe organeve juridike në mbrojtjen e konsumatorit
Java e trembëdhjetë:	Mbrojtja e konsumatorëve në shtetet e zhvilluara
Java e katërbëdhjetë:	Shqyrtimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit i Kosovës; Programi për mbrojtjen e konsumatorit në Republikën e Kosovës
Java e pesëmbëdhjetë:	Kollofiumi i dytë
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
<p>Sjelljet e poshtëshënuara janë në kundërshtim me politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vonesa në ligjerata dhe ushtrime; • Lëshimi i sallës gjatë ligjeratave ose ushtrimeve (pa arsyeje të nevojshme); • Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit dhe të folurit të pandërprerë ose formave tjera të sjelljes që pengojnë procesin e rregullt të mësimin; • Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjeratave ose ushtrimeve, do të rezultojnë me humbje të pikëve për shkak të sjelljes joprofesionale. <p>Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga veprimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kopjimi gjatë provimit ose testit; • Shfrytëzimi i shenimeve ose librave të palejuara gjatë testit ose provimit; • Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit; • Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dikë nga mësimi, ushtrimi apo provimi. 	